



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 qershor 2022
Nr. ref.:RK 2001/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI226/21

Parashtrues

Bajram Gegaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme
PML.nr.378/2021 i 4 nëntorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Bajram Gegaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) i përfaqësuar nga Esat Gutaj, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtrues i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [PML.nr.378/2021], të 4 nëntorit 2021, përmes të cilit pretendohet se është shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 8 dhjetor 2021, parashtrues i kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 15 dhjetor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
7. Më 16 dhjetor 2021, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh në pajtim me rregullin 32 të Rregullores së punës, të dorëzojë autorizimin që dëshmon se ai e përfaqëson parashtruesin e kërkesës në procedurë në këtë Gjykatë.
8. Më 29 dhjetor 2021, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi autorizimin e lartpërmendur.
9. Më 14 mars 2021, Gjykata njoftoi dhe dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën Supreme.
10. Më 11 maj 2022, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 11 qershor 2019, Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, kishte parashtruar aktakuzën PP/I.nr.35/2019 kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 paragrafi 1 nën-paragrafët 1.3 dhe 1.5 të KPK-së, veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 në lidhje me nenin 28 të KPK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 i KPK-së.
12. Prokurori i Shtetit M.D., në fjalën përfundimtare në Gjykatën Themelore në Prizren kishte deklaruar se Prokuroria Themelore në Prizren në tërësi mbetet pranë aktakuzës ndaj të akuzuarit (parashtruesit të kërkesës) për shkak se ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë, veprën penale të vrasjes në tentativë dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve. Nga provat e administruara dhe nga deklaratat e dëshmitarëve, parashtruesi i kërkesës kishte privuar nga jeta vëllain e tij I.G., dhe kishte plagosur rëndë të dëmtuarën N.G.
13. Më 29 janar 2021, Gjykata Themelore në Prizren përmes Aktgjykimit [PKR.nr.44/19] vendosi që: **(i)** parashtruesi i kërkesës është fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPK); **(ii)** parashtruesi i kërkesës është fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 i KPK-së; **(iii)** parashtruesi i kërkesës lirohet nga akuza përkitazi me veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK-së; **(iv)** parashtruesit të kërkesës i shqiptohet dënim unik prej njëzetekatër (24) vitesh, në të cilin dënim llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 17.03.2019; **(v)** pala e dëmtuar N.G., udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil për realizim të kërkesës pasurore-juridike.
14. Gjykata Themelore konstatoi: **(i)** me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimin e tyre veç e veç ka vërtetuar gjendjen faktike se në ditën kritike në fshatin Studeçan, komuna e Suharekës, parashtruesi i kërkesës pas një mosmarrëveshje rreth çështjeve pronësore me dashje privon nga jeta vëllain e tij I.G., dhe po ashtu qëllon me armë zjarri në abdomen të dëmtuarën N.G; **(ii)** me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se parashtruesi i kërkesës ka kryer edhe veprën penale të vrasjes në tentativë kundër të dëmtuarës N.G., siç parashikohet me nenin 178 lidhur me nenin 28 të KPK-së; **(iii)** Gjykata Themelore ka refuzuar propozimin e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës që të bëhet edhe një herë ekspertiza psikiatrike për parashtruesin e kërkesës brenda dhe jashtë Kosovës sepse bazuar në ekspertizën e ekspertëve është konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur probleme psikiatrike apo që ndonjëherë është trajtuar në ndonjë institucion për shkak të shëndetit mendor; **(iv)** si rrethanë rënduese, Gjykata Themelore vlerësoi peshën e veprës penale, mënyra e kryerjes së veprës penale, vendin ku është kryer vepra penale, rrezikimi i personave tjerë, pasoja e shkaktuar ku ka mbetur i vdekur vëllai i tij I.G., dhe një person tjetër ka pësuar lëndime të rënda trupore; **(v)** si rrethanë lehtësuese, Gjykata Themelore vlerësoi sjelljen korrekte të parashtruesit të kërkesës në gjykatë, moshën e tij, gjendjen e tij ekonomike dhe se është i martuar babë i pesë (5) fëmijëve.

15. Mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës paraqiti ankesë duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozimi që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe parashtruesi i kërkesës të shpallet fajtor për vepër penale vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore nga neni 180 i KPK-së, ose çështja të anulohet dhe t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.
16. Prokuroria Themelore, për pjesën liruese, paraqiti ankesë duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, ndërsa, për pjesën dënuese për vendimin për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarin ta shpall fajtor edhe për veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 në lidhje me nenin 28 të KPK-së, e po ashtu, t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, për dy veprat penale sipas propozimit të aktakuzës.
17. Më 21 maj 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.169/21] vendosi: **(i)** që pjesërisht ta aprovojë ankesën e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës dhe e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [PKR.nr.44/19] të 29 janarit 2021, vetëm përkitazi me cilësim të veprës penale, ashtu që, vepra penale vrasje e rëndë nga neni 179 paragrafi 1 nën-paragrafët 3 dhe 5 të KPK-së, për të cilën është shpallur fajtor parashtruesi i kërkesës, kjo Gjykatë e cilëson si vepër penale vrasje e rëndë nga neni 179 paragrafi 1 nën-paragrafi 3 të KPK-së; **(ii)** ankesa e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës, për bazat tjera ankimore si dhe ajo e prokurorisë refuzohen si të pabazuara, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar për pjesën tjetër vërtetohet.
18. Gjykata e Apelit arsyetoi: **(i)** gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh deklaratat e dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes, të cilët kanë vërtetuar faktet dhe rrethanat përkitazi me marrëdhëniet jo të mira ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe viktimës I.G., që edhe kanë qenë arsyeja kryesore që ka çuar te dita kritike e vrasjes së viktimës I.G., nga parashtruesi i kërkesës; **(ii)** plotësohen të gjitha elementet e veprës penale nga neni 179, paragrafi 1 nën-paragrafi 3 i KPK-së, për të cilën parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor duke përjashtuar nën-paragrafin 5 të KPK-së për të cilën me të drejtë është pretenduar që gjykata e shkallës së parë, ka bërë tejkalimin e akuzës, për çka, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit duke e hequr formën kualifikuese nga nën-paragrafi 5, që do të thotë se mbetet vrasje e rëndë, por vetëm nga nën-paragrafi 3 i nenit 179 të KPK-së; **(iii)** lidhur me veprën penale vrasje në tentativë nga nenin 178 lidhur me nenin 28 të KPK-së, gjykata e shkallës së parë e ka liruar parashtruesin e kërkesës nga kjo pikë e aktakuzës me arsyetim se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer edhe veprën penale në fjalë; **(iv)** nuk ka shkelje të ligjit penal në favor të parashtruesit të kërkesës sikur që pretendon prokuroria kur parashtruesi i kërkesës u lirua nga akuza për veprën penale vrasje në tentativë ngase veprimet inkriminuese në drejtim të të dëmtuarës N.G., janë konsumuar në veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 paragrafi 1, nën-paragrafi 3 i KPK-së; **(v)** pretendimi mbrojtësit se parashtruesi i kërkesës është dashur të shpallet fajtor për vepër penale vrasje në gjendje të tronditjes së fortë mendore nga neni 180 i KPK-së është i pabazuar, sepse nga gjendja faktike e

vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk rezulton që viktimja I.G., të ketë ndërmarrë edhe vetëm një veprim fizik apo psikik, e që do të mund të kualifikohej si provokim që pastaj parashtruesi i kërkesës të ketë vepruar në afekt mendor; **(vi)** pretendimet e prokurorisë për ashpërsim të dënimit nuk janë të bazuara ngase në ankesë nuk përmendet asnjë rrethanë konkrete rënduese që do të ndikonte në ashpërsimin e mëtutjeshëm të dënimit; **(vii)** po ashtu, mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës nuk çekë asnjë rrethanë konkrete lehtësuese të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë.

19. Mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje të ligjit penal, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të dispozitave tjera të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe ka propozuar që aktgjykimet të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
20. Prokurori i Shtetit propozoi që të refuzohet e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës.
21. Më 4 nëntor 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML.nr.378/2021] e refuzoi të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren [PKR.nr.44/2019] të 29 janarit 2021 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PAKR.nr.169/21] të 21 majit 2021.
22. Gjykata Supreme arsyetoi: **(i)** aktgjykimi i shkallës së parë respektivisht dispozitivi i të njëjtit është i qartë, i kuptueshëm dhe ky dispozitiv nuk është në kundërtënie as me vetveten e as me arsyetimin e aktgjykimit; **(ii)** me deklaratat e dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes është dëshmuar se raportet ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe viktimës I.G., kanë qenë jo të mira për shkak të mosmarrëveshje pronësore që kanë çuar deri tek dita kritike e vrasjes së viktimës I.G.; **(iii)** nga shkresat e lëndës vërtetohet se parashtruesi i kërkesës është dërguar për ekspertizë psikiatrike përkitazi me gjendjen emocionale në momentin e kryerjes së veprës penale dhe nga kjo ekspertizë e cila është administruar dhe vlerësuar si provë në shqyrtimin gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, është konstatuar se në momentin e kryerjes së veprës penale parashtruesi i kërkesës ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet e veta dhe të kuptojë rëndësinë e veprimit të tij; **(iv)** sipas provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë vërtetohet se në momentin kritik viktimja I.G., nuk i ka kontribuar kryerjes së veprës penale, e po ashtu me ekspertizë psikiatrike është konstatuar se tek parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur asnjë arsye që ka mundur të ndikojë në aftësinë e tij mendore; **(v)** ligji penal është aplikuar drejtë kur parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.3 të KPK-së meqenëse në veprimet e të njëjtit formohen elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, duke u bazuar në vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike; **(vi)** në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimet e parapara për këto vepra penale, ndërsa duhet të theksohet se është në diskrecionin e gjykatës vlerësimi i rrethanave në çdo rast konkret e përveç kësaj janë dhënë arsye ligjore të cilat kanë ndikuar në shqiptimin e dënimit, andaj, as në këtë drejtim nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
24. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Gjykata ka qenë dashur të bëj kualifikimin e veprës penale dhe jo si në dispozitiv të Aktgjykimit me të cilin i shpall fajtor të akuzuarit, në rastin konkret Gjykata e shkallës së parë përveç që ka bërë shkelje esenciale të dispozitave, ka bërë edhe shkelje esenciale të dispozitës së procedurës penale nga neni 384 par.1 nen par.10 të KPPK-së.”*
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Gjykata ka qenë dashur të arsyetoj Aktgjykimin e saj ku kërkohet për t’u konsideruar valid vlerësimi mjekësor si dhe obligimin e organeve procedurale që t’i vërtetojnë saktësisht shikimet psikiatrike ndaj të akuzuarit dhe tërësisht faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.”*
26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në çastin e kryerjes së veprës penale “nuk ka qenë në dijeni gjatë aktit të kryerjes së veprës penale” as për rëndësinë as për peshën dhe as dënimin e veprave penale që i janë ngarkuar me aktgjykim.
27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë dhe shkallës së dytë është i pakuptueshëm, kontradiktor me vetveten e në veçanti arsyetimet e aktgjyqimeve dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Parashtruesi po ashtu pretendon se edhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme është kontradiktor për shkak të refuzimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë me ç’rast atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë dhe konventat ndërkombëtare.
28. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Gjykata absolutisht nuk i ka sqaruar-se cilat prova i ka dhënë si fakt të provuar apo, të paprovuar dhe as nuk ka dhënë pretendime te nevojshme që do të dërgonin deri në rezultatin e Gjykatës së Shkalles së Parë, e ka në rastin konkret del në kundërshtim të plotë në deklaratat e të akuzuarit të dhënë gjatë fazës së hetimeve, e cila fare nuk është marre parasysh si rrethanë-raportet e të akuzuarit me viktimën, me tani të ndjerin I.G., raporte të cilat kanë ndikuar në kryerjen e veprës penale, për pasoj ndaj se cilës ka ardhur deri te veprimet e të akuzuarit si pasoj e sjelljeve të të ndjerit me të akuzuarin.”*
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në procesin penal kundër tij ka pasur lëshime qysh nga marrja në pyetje në polici, prokurori dhe gjykatë ngase është dashur që ai menjëherë të dërgohet në shikim psikiatrik nga mjekët profesional me ç’rast do të konstatohet gjendja e tij mendore.

Dispozitat relevante ligjore

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 28 **Tentativa**

1. Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale.
2. Tentativa për të kryer vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me tre ose më shumë vjet burgim dënohet. Tentativa për të kryer ndonjë tjetër vepër penale dënohet vetëm nëse shprehimisht parashihet me ligj.
3. Personi që tenton të kryejë vepër penale dënohet si të kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet.

Neni 178 **Vrasja**

Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

Neni 179 **Vrasja e rëndë**

1. Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili:

[...]

- 1.3. privon nga jeta anëtarin e familjes;

[...]

- 1.5. privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë;

Neni 180 **Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore**

Kushdo që personin tjetër e privon nga jeta në gjendje të tronditjes së fortë mendore, të shkaktuar pa fajin e tij nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e personit të vrarë, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 374 **Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve**

1. Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Arma në pronësi, kontroll apo posedim në shkelje të këtij neni konfiskohet.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

Nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të parashikuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashohin:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

33. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të saj. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PML.nr.378/2021], të 4 nëntorit 2021, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të parashikuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

34. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikon:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

35. Gjykata rikujton që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesën të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme në bazë të dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KI04/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin KI175/21, parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

36. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*. (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi të pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”*, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; Pjesa III. Papranueshmëria bazuar në

merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284, shih gjithashtu rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin KI175/21, cituar më lart, paragrafi 38).

37. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28).
38. Gjykata përsëritë se esenca e këtij rasti është se parashtruesi i kërkesës kishte pasur mosmarrëveshje pronësore me vëllain e tij I.G., të cilin më vonë e kishte vrarë dhe po ashtu kishte plagosur të dëmtuarën N.G. Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, kishte parashtruar aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë, veprës penale të vrasjes në tentativë dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 i KPK-së. Gjykata Themelore në Prizren vendosi që parashtruesi i kërkesës është fajtor për shkak të kryerjes së veprave penale vrasje e rëndë dhe mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve; ndërsa e liroi parashtruesin e kërkesës nga akuza përkitazi me veprën penale të vrasjes në tentativë. Gjykata e Apelit vendosi që ta ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore vetëm përkitazi me cilësim të veprës penale, ashtu që, veprën penale vrasje e rëndë cilëson si vepër penale vrasje e rëndë nga neni 179 paragrafi 1 nën-paragrafi 3 të KPK-së. Mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje të ligjit penal, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të dispozitave tjera të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe ka propozuar që aktgjykimet të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata Supreme refuzoi të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës të ushtruar kundër aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit.
39. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta janë kontradiktore, të paqarta dhe nuk kanë sqaruar provat që i kanë përdorë për nxjerrje të konstatimit se ai është fajtor për veprat penale të vrasjes së rëndë dhe mbajtjes në pronësi dhe kontroll të paautorizuar të armëve. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se “ai është dashur të dërgohet për ekzaminim psikiatrik menjëherë” dhe në këtë kontekst ka “pasur lëshime” qysh nga fillimi i procedurës në polici, prokurori dhe gjyqësorë. Për shkak të këtyre shkeljeve të pretenduara parashtruesi i kërkesës pohon se në dëm të tij është shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës.
40. Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka konstatuar: **(i)** aktgjykimin i shkallës së parë respektivisht dispozitivi

i të njëjtit është i qartë, i kuptueshëm dhe ky dispozitiv nuk është në kundërtënie as me vetveten e as me arsyetimin e aktgjykimit; **(ii)** me deklaratat e dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes është dëshmuar se raportet ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe viktimës I.G., kanë qenë jo të mira për shkak të mosmarrëveshje pronësore që kanë çuar deri tek dita kritike e vrasjes së viktimës I.G.; **(iii)** nga shkresat e lëndës vërtetohet se parashtruesi i kërkesës është dërguar për ekspertizë psikiatrike përkitazi me gjendjen emocionale në momentin e kryerjes së veprës penale dhe nga kjo ekspertizë e cila është administruar dhe vlerësuar si provë në shqyrtimin gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, është konstatuar se në momentin e kryerjes së veprës penale parashtruesi i kërkesës ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet e veta dhe të kuptojë rëndësinë e veprimit të tij; **(iv)** sipas provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë vërtetohet se në momentin kritik viktimë I.G., nuk i ka kontribuar kryerjes së veprës penale, e po ashtu me ekspertizë psikiatrike është konstatuar se tek parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur asnjë arsye që ka mundur të ndikojë në aftësinë e tij mendore; **(v)** ligji penal është aplikuar drejtë kur parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.3 të KPK-së meqenëse në veprimet e të njëjtit formohen elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, duke u bazuar në vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike; **(vi)** në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimet e parapara për këto vepra penale, ndërsa duhet të theksohet se është në diskrecionin e gjykatës vlerësimi i rrethanave në çdo rast konkret e përveç kësaj janë dhënë arsye ligjore të cilat kanë ndikuar në shqiptimin e dënimit andaj as në këtë drejtim nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

41. Nga sa më sipër, Gjkata vë në spikamë arsyetimin relevant të Gjykatës Supreme që konstaton: *“Kjo gjykatë duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes gjen se aktgjykimi i shkallës së parë respektivisht dispozitivi i të njëjtit është i qartë, i kuptueshëm dhe ky dispozitiv nuk është në kundërtënie as me vetveten e as me arsyetimin e aktgjykimit [...] nga i akuzuari është konfiskuar një pistoletë me mbishkrim HS-9 e kalibrit 9x19 prodhim kroat, me nr. Serik H107964 si dhe një pushkë gjuetie model CSP555 prodhim turk e kal. 12-GA me nr. Serik 175130 si dhe 4 fishek të kalibrit të njëjtë [...] në arsyetim të këtij aktgjykimi janë dhënë të gjitha arsyet ligjore për faktet dhe provat të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor duke i përfshirë edhe provat kontradiktore si dhe duke dhënë arsye ligjore se për çfarë i ka dhënë besimin provave dhe fakteve vendimtare mbi bazën e të cilave është marrë vendimi meritor në këtë çështje penale. Kjo gjykatë gjen se edhe gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe se i ka pranuar të gjitha vlerësimet mbi bazën e të cilave është marrë vendimi meritor në këtë çështje penale. Kështu, në shkresat e çështjes vërtetohet se i dënuari B.G., është shpallur fajtor për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nënpar. 1.3 të KPRK-se dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së. Me aktgjykimin e ndryshuar me aktgjykim të gjykatës së shkallës së dytë e duke u bazuar në deklaratat e dëshmitarëve okularë në vendin e ngjarjes dhe atë të dëshmitarit FG, HG, AD dhe dëshmitares të dëmtuarës NG si dhe HG dhe SG, të cilët dëshmitarë me deklaratat identike dëshmojnë se raportet në mes të dënuarit Bajram dhe viktimës IG, kanë qenë jo të mira për shkak të mosmarrëveshjeve pronësore e të cilat mosmarrëveshje kanë çuar deri te dita*

kritike respektivisht te vrasja e të ndjerit IG. Nga këto deklarata vërtetohet se nuk qëndron pretendimi i mbrojtjes se vepra penale është kryer në gjendje të rënduar emocionale dhe se të dënuarin BG është dashur menjëherë të dërgohet në shikim psikiatrik me çka do të vërtetohej gjendja e aftësisë mendore menjëherë pas kryerjes së veprës penale. Në fakt nga shkresat e lëndës vërtetohet se i dënuari Bajram Gegaj është dërguar për ekspertizë psikiatrike përkitazi me gjendjen emocionale në momentin e kryerjes së veprës penale dhe nga kjo ekspertizë e cila është administruar dhe vlerësuar si provë në shqyrtimin gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, është konstatuar se në momentin e kryerjes së veprës penale i dënuari ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet e veta dhe të kuptojë rëndësinë e veprimit të tij. Ndërsa, propozimi i mbrojtjes që për të dënuarin të bëhet një ekspertizë tjetër psikiatrike, është refuzuar nga gjykata e shkallës së parë për çka është dhënë arsyetim. Sipas kësaj gjykate dhe sipas provave të administruara, vërtetohet se me asnjë veprim të veten i dëmtuari në momentin kritik nuk i ka kontribuar kryerjes së veprës penale, e po ashtu me ekspertizë psikiatrike është konstatuar se tek i dënuari nuk ka pasur asnjë arsye që ka mundur të ndikojë e tij mendore [...] Kjo gjykatë gjen se edhe ligji Penal është aplikuar drejtë kur i dënuari është shpallur fajtor për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nenpar.1.3 të KPRK-së meqenëse në veprimet e të njëjtit formohen elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, e duke u bazuar në vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimet e parapara për këto vepra penale, ndërsa duhet të theksohet se është në diskrecionin e gjykatës vlerësimi i rrethanave në çdo rast konkret e përveç kësaj janë dhënë arsye ligjore të cilat kanë ndikuar në shqiptimin e dënimit andaj as në këtë drejtim nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.”

42. Gjukata vëren se gjykatat e rregullta nga provat e mbledhura dhe dëshmitë e dëshmitarëve okularë kanë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se parashtruesi i kërkesës është fajtor për vrasjen e viktimës I.G., dhe se po ashtu tek parashtruesi i kërkesës janë gjetur armë të paautorizuara të prodhimit turk dhe kroat. Gjukata po ashtu vlerëson se gjykatat e rregullta kanë konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk e ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në gjendje të tronditjes së fortë mendore sepse nga ekzaminimet psikiatrike është vërtetuar e kundërta. Po ashtu gjykatat e rregullta kanë vërtetuar se viktimë I.G., nuk ka pasur asnjë sjellje provokuese në drejtim të parashtruesit të kërkesës që do ta nxiste këtë të fundit që të kryente veprime kriminale në gjendje të tronditjes së fortë mendore.
43. Nga sa më sipër, Gjukata vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se gjykatat nuk kanë treguar provat që kanë shërbyer si bazë për nxjerrjen e konstatimeve të tyre, janë qartazi të pabazuara.
44. Gjukata konstaton se parashtruesi i kërkesës përfitoi nga procedura kontradiktore dhe se ai ishte në gjendje të paraqes në faza të ndryshme të procedurës pretendimet dhe provat që ai i konsideroi të rëndësishme për rastin e tij; ai ka pasur mundësinë të hedh poshtë në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtarë; gjykatat e rregullta dëgjuan dhe shqyrtuan të gjitha pretendimet e tij, të cilat, shikuar objektivisht, ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit; arsyet faktike dhe ligjore për vendimin e

kontestuar janë dhënë në hollësi dhe procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, *mutatis mutandis*, aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30, shih gjithashtu rastin KI22/19, *Parashtrues Sabit Ilazi*, aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rasti KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).

45. Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si rezultat i vërtetimit të gabuar të fakteve dhe interpretimit të gabuar të ligjit, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës apo se procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe se të njëjtat i kanë arsyetuar (Shih në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI64/20, *Parashtrues i kërkesës, Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41, dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
46. Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës.
47. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme bazuar në nenet 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 11 maj 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani